

SI TË APLIKOSH PËR DEKLARATË PARAPRAKË PËR KRYERJE PUNIMESH

UDHËZUES PËR PROFESIONISTËT DHE QYTETARËT



BASHKIA
TIRANË

Udhëzuesi për profesionistët dhe qytetarët:

“Si të aplikosh për Deklaratë paraprake për kryerje punimesh”

AUTOR

Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit,
Bashkia Tiranë.

UDHËHEQËS TË PROCESIT:

Ditjon Baboçi, Drejtor i Përgjithshëm

Drejtoria e përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Frida Pashako, Drejtor

Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit

Anisa Mançe, Pergjegjes Sektor

Sektor i Shqyrtimit të Aplikimeve

DREJTUES I GRUPIT TË PUNËS:

Iva Tavanxhiu, Specialiste

Sektor i Makroplanifikimit

GRUPI I PUNËS:

Specialistë

Sektor i Shqyrtimit të Aplikimeve:

Adelina Farruku, Ana Hoxha, Alba Metoja, Alda Zholi, Boriana Vrusho, Eris Qazimi, Erlend Baballëku, Frida Dragusha,

Griselda Gjika, Kleant Bibolli, Melania Keçi, Mirela Gjika.

REALIZIMI GRAFIK:

Iva Tavanxhiu

Tiranë, 2018

SHËNIM I RËNDËSISHËM

Roli i këtij udhëzuesi është orientues për mënyrën e aplikimit të *Deklaratës paraprake për Kryerje Punimesh* dhe do të jetë vazhdimisht në proces përditësimi në varësi të ndryshimit të legjislacionit, rregulloreve në zbatim të ligjeve përkatëse në fuqi, urdhëresave të ndryshme apo koncepteve që kanë nevojë të spjegohen.

Sugjerimet e dhëna në këtë udhëzues nuk janë shteruese, pasi vetë rastet e aplikimit për *Deklaratë Paraprake për Kryerje Punimesh* janë nga më të ndryshmet dhe trajtimet e tyre nuk janë standarte.

Shembujt e sjellë në këtë udhëzues janë raste ilustruese, tek të cilat mund të referoheni.

Referencat ligjore të cituara në këtë udhëzues i përkasin kohës së përgatitjes së tij, prandaj çdo përdorues i këtij udhëzuesi duhet të jetë i kujdesshëm t'i referohet bazës ligjore të përditësuar nga burimet zyrtare në momentin e përdorimit të tij.

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	6
HAPI 01 - APLIKIMI ME DEKLARATË PARAPRAKE PËR KRYERJE PUNIMESH NË PRONËSI PUBLIKE	17
HAPI 1/1 - PAJISJA ME LEJE SHFRYTËZIMI TË HAPËSIRËS PUBLIKE	25
HAPI 1/2 - SHQYRTIMI I KËRKESËS, AFATET KOHORE & PAGESA E TARIFES SË APLIKIMIT PËR LEJEN E SHFRYTËZIMIT TË HAPËSIRËS PUBLIKE	31
HAPI 1/3 - HARTIMII I PROJEKTIT TEKNIK TË REALIZIMIT TË PUNIMEVE	37
HAPI 1/4 - DOKUMENTAT E NEVOJSHME PËR APLIKIM ME DPKP NË PRONË PUBLIKE	41
HAPI 02 - APLIKIMI ME DEKLARATË PARAPRAKE PËR KRYERJE PUNIMESH NË PRONËSI PRIVATE	45
HAPI 2/1 - APLIKIMI ME DPKP NË PRONËSI PRIVATE ME ÇERTIFIKATË PRONËSIE	47
HAPI 2/1 - APLIKIMI ME DPKP NË PRONËSI PRIVATE ME KONTRATË POROSIE / SIPËRMARRJE/ QERAJE	51
HAPI 2/2 - HARTIMII I PROJEKTIT TEKNIK TË REALIZIMIT TË PUNIMEVE	55
HAPI 2/3 - DOKUMENTAT E NEVOJSHME PËR APLIKIM ME DPKP NË PRONË PRIVATE	59
HAPI 03 - APLIKIMI ONLINE, SHQYRTIMI I KËRKESËS & AFATET KOHORE	63
PERMBLEDHJA E PROCESIT TË APLIKIMIT PËR LEJE ZHVILLIMI	

➤ HYRJE

Udhëzuesi për profesionistët dhe qytetarët u përgatit nga Bashkia e Tiranës me mbështetje teknike të Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

QËLLIMI I UDHËZUESIT

Udhëzuesi “Si të aplikosh për Deklaratë paraprake për kryerje punimesh” i vjen në ndihmë profesionistëve të fushës si planifikues urbanë, urbanistë, arkitektë dhe të interesuarve që aplikojnë për Deklaratë paraprake për kryerje punimesh duke i udhëzuar për bazën ligjore, dokumentacionin e nevojshëm për pajisjen me leje, autoritetet të cilët kanë të drejta vendimarrje, afatet e kërkuara, etj.

MENYRA TË TJERA INFORMIMI PËRVEÇ KËTIJ UDHËZUESI

Për çdo pyetje apo informim mbi mënyrën e aplikimit për Deklaratë paraprake për Kryerje Punimesh mund të interesoheni pranë:

- Zyrave të Komunikimit me Qytetarët pranë Bashkisë së Tiranës
- Portalit zyrtar të Bashkisë së Tiranës:

www.tirana.al

➤ UDHËZUES TË TJERË APLIKIMI PER LEJE

Ky udhëzues është pjesë e një pakete informative për zbatimin e bazës tekniko - ligjore sipas kushteve të zhvillimit të përcaktuara në legjislacionin dhe rregulloret përkatëse në fuqi, së bashku me Udhëzuesin “Si të aplikosh për Plan të Detajuar Vendor”, Udhëzuesin “Si të aplikosh për Leje Zhvillimi” dhe Udhëzuesin “Si të aplikosh për Leje Ndërtimi”.



➤ AKRONIME

- PPV** – Plan i Përgjithshëm Vendor
- PDV** – Plan i Detajuar Vendor
- DPKP** – Deklaratë Paraprake për Kryerje Punimesh
- DPPZHT** – Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit
- DPT** – Drejtoria e Planifikimit të Territorit
- ZVRPP** – Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
- KT** – Këshill Teknik

➤ ÇFARË ËSHTË DEKLARATA PARAPRAKE PËR KRYERJE PUNIMESH ?

“ Deklarata Paraprake për Kryerje Punimesh, përfshin të gjitha ato punime që për shkak të ndërhyrjeve jo-thelbësore në objekt, natyrës së përkohshme së instalimeve ose rregullimit të kontrollit të zhvillimit nga një leje apo autorizim tjetër apo nga legjislacion i posaçëm sektorial, **nuk kërkojnë pajisjen me një leje ndërtimi.** ”

Këto lloje punimesh konsistojnë në punime me anë të të cilave bëhet ndryshimi i organizimit të hapësirës në parcele apo objekt, zëvendësimi i aparaturave dhe pajisjeve ekzistuese, si dhe ndryshimet, të cilat nuk ndikojnë në qëdrueshmërinë dhe sigurinë e objektit e nuk ndryshojnë elementet konstruktive mbajtëse. ”

➤ NË ÇFARË RASTI APLIKOJMË PËR DEKLARATË PARAPRAKE PËR KRYERJE PUNIMESH?

Në të rastet që përfshihen punimet me anë të të cilave bëhet ndryshimi i organizimit të hapësirës në objekt, zëvendësimi i aparaturave dhe pajisjeve ekzistuese, si dhe ndryshimet, të cilat nuk ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit e nuk ndryshojnë elementet konstruktive mbajtëse, si:

➤ (I) PUNIME TË JASHTME:

- ndërhyrjet e mirëmbajtjes së zakonshme kur sjellin ndryshime të karakteristikave, formave dhe ngjyrave ekzistuese
- vendosja e shtresave për rritjen e efikasitetit energjetic të ndërtesave ekzistuese.

➤ (II) PUNIME TË BRENDSHME, SI:

- përforcimi i strukturave mbajtëse të brendshme;
- hapja dhe mbyllja e dyerve të brendshme;
- krijimi, eliminimi ose ndryshimi i mureve ndarës (jombajtës) të brendshëm, i mjediseve për shërbime higjienike;
- realizimi i impianteve të reja higjieno-sanitare dhe të ngrohjes/ftohjes;

➤ (III) PUNIME TË TJERA, SI:

- punimet për ndërtimin e rampave për përshtatjen e ndërtesave për personat me aftësi të kufizuara;
- struktura që instalohen për nevoja të çastit dhe të përkohshme, pa themele, me materiale të

◀ SHËNIM

Nëse rasti juaj nuk klasifikohet si aplikim për deklaratë paraprake për kryerje punimesh, referojuni udhëzuesve të tjerë për aplikim për leje (faqe 7).

çmontueshme, pa përdorur struktura beton-armeje, blloqe betoni, murature e soleta dhe që hiqen në çdo rast, brenda një afati kohor maksimal 6-mujor;

- vendosja e paneleve diellore, fotovoltaike, në shërbim të ndërtesave, në përputhje me rregulloren arkitektonike të qytetit dhe kufizimet që mund të rrjedhin nga legjislacioni për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, historike apo mjedisore;

- punime riparimi, zëvendësimi dhe mirëmbajtjeje të rrjeteve të infrastrukturës publike dhe komunikimeve elektronike, që nuk prekin sistemin konstruktiv të tyre, nuk ndryshojnë përdorimin dhe përmasat e infrastrukturës, si dhe kushtet e zhvillimit në zonën përreth;

- punime riparimi, mirëmbajtjeje dhe rehabilitimi të infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja;

- vendosja e tendave të diellit dhe pergolateve, në përputhje me ligjin që rregullon bashkë-pronësinë në ndërtesat e banimit dhe rregulloren arkitektonike të qytetit;

- ndërhyrjet me qëllim ruajtjen apo rritjen e efikasitetit energjetic dhe akustike në një strukturë ekzistuese, që nuk prekin sistemin konstruktiv të ndërtesës (p.sh.: ndërhyrje në themele, mure mbajtëse, tra-kolonë etj.)

- serra të çmontueshme, pa themele të vazhduara, në shërbim të aktiviteteve bujqësore; - vendosja e ashensorëve;

- vendosja e reklamave në fasadat e jashtme, për qëllime të promovimit të aktivitetit ekonomik privat. Vendosja e tyre rregullohet sipas rregullores specifike të secilit autoritet vendor të planifikimit, me përjashtim të vendosjes së reklamave jashtë territoreve urbane, ku përfshihen, por pa u kufizuar, rrugë interurbane, hekurudha, mjedise aeroportuale, pika doganore, të cilat rregullohen me akte të ministrive përgjegjëse.

➤ NË ÇFARË RASTI NUK APLIKOJMË PËR DEKLARATË PARAPRAKE PËR KRYERJE PUNIMESH?

Pa përjashtuar detyrimin e respektimit të dispozitave të parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi për veprimtaritë ndërtimore përfshirë, në mënyrë të veçantë, sa i përket qëndrueshmërisë antisizmike, mbrojtjes kundër zjarrit, ruajtjes së sigurisë dhe higjienës shëndetësore, ndërhyrjet e mëposhtme kryhen pa pajisje me leje ndërtimi dhe pa paraqitur deklaratë paraprake punimesh:

➤ A) NDËRHYRJE TË MIRËMBAJTJES SË ZAKONSHME:

(i) ndërhyrje të jashtme për riparimin dhe zëvendësimin e rifiniturave të jashtme të ndërtesave, me kusht që të ruhen karakteristikat origjinale të tyre, si më poshtë vijon:

- - rifreskimi i ljerjes, suvatimit dhe veshjes së fasadave me materiale që kanë karakteristika dhe ngjyra të njëjta me ato ekzistuese
- pastrimi i fasadave
- riparimi dhe zëvendësimi i dritareve dhe dyerve, qepenave dhe vitrinave (duke përfshirë përdorimin e materialeve të ndryshme), pa ndryshuar karakteristikat e tilla si, forma, ngjyra, dizajni dhe dimensionet e pjesëve të hapura dhe transparente
- - zëvendësimi i pjesshëm i mbulesës së çatisë, pa ndonjë ndryshim të formës, pjerrësisë dhe karakteristikave të veshjes
- riparimi dhe zëvendësimi i ulluqeve e oxhakëve, edhe me materiale të ndryshme
- riparimi i ballkoneve, tarracave dhe basamakëve apo barrierave mbrojtëse
- vendosja e hekurave mbrojtës në dritare

◀ SHËNIM

Për ndërhyrjet e listuara më poshtë, aplikuesi i drejtohet zyrave të njësisë administrative përkatëse.

- vendosja e tendave të diellit dhe rretave kundër mushkonjave
- sistemimi i oborreve
- riparimi i rrethimeve ekzistuese

(ii) ndërhyrje të brendshme:

- riparimi dhe rinovimi i dyshemeve
- riparimi dhe restaurimi i suvasë, veshjeve dhe ngjyrave
- riparimi dhe rinovimi i dyerve dhe dritareve, përfshirë vendosjen e xhamave të dyfishtë

(iii) ndërhyrje në impiante higjieno-sanitare:

- veprat e riparimit dhe zëvendësimit të pajisjeve higjieno-sanitare dhe riparimet e impiantit

B) PUNIMET PËR ELEMIMIN E BARRIERAVE ARKITEKTONIKE DHE PËRSHTATJEN E NDËRTESAVE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

C) LËVIZJET E DHEUT QË LIDHEN, NË MËNYRË TË POSAÇME, ME USHTRIMIN E VEPRIMTARISË BUJQËSORE OSE BLEGTORALE, PËRFSHIRË NDËRHYRJET NË IMPIANTE HIDRAULIKE BUJQËSORE.

➤ MËNYRA E APLIKIMIT

Aplikimi për Deklaratë Paraprake për Kryerje Punimesh kryhet **VETËM** në **MËNYRË ELEKTRONIKE** nëpërmjet **PORTALIT ONLINE E-LEJE** pjesë e platformës **E-ALBANIA**.

Ky portal mundëson shërbimin me një ndalese dhe procedura të thjeshtuara, transparente dhe të shpejta, redukton pengesat administrative dhe përmirëson praktikën e aplikimit për lejet përkatëse.

www.e-albania.al

REGJISTROHU
e-albania
HYR

Ndihmë dhe suport

Kërko shërbimin

Aplikimi për Leje Ndërtimi (e-Lejet)

Ju duhet të identifikoheni në portal për të përdorur këtë shërbim!

HYR REGJISTROHU

Ky shërbim elektronik ju ofron mundësinë e aplikimit online për leje ndërtimi nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania

Kërkesë për lëshimin e deklaratës paraprake për kryerje punimesh (Për më tepër instruksione klikoni këtu);

01

APLIKIMI ME DEKLARATË PARAPRAKE
PËR KRYERJE PUNIMESH
NË **PRONËSI PUBLIKE**



➤ APLIKIMI ME DPKP NË PRONËSI PUBLIKE

Personi / subjekti që kërkon të ushtrojë aktivitetin e tij në hapësirat publike duhet të pajiset me **Leje të shfrytëzimit të hapësirës publike** nga Bashkia e Tiranës.

SHIKO HAPIN 1/2 dhe më pas apliko për Deklaratë Paraprake për Kryerje Punimesh online.

- Leja për shfrytëzimin e hapësirës publike merret pranë **Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Traifave Vendore**.
- Nëse subjekti kërkon leje për një hapësirë publike në një zonë me vlera monumentale kjo leje do të lëshohet në bashkëpunim / bashkërendim me Institutin e Monumenteve të Kulturës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Subjekti është i detyruar që lejen e lëshuar nga Bashkia ta ketë të vendosur në një vend të dukshëm në rastet kur kemi të bëjmë me zënie të hapësirës publike të qëndrueshme. Në të kundërt, të ketë lejen kurdoherë me vete nëse zënia e hapësirës publike kryhet në mënyrë jo të qëndrueshme.

➤ AKTIVITETET QË MUND TË ZHVILLOHEN NË HAPËSIRAT PUBLIKE

Kategoritë e aktiviteteve që lejohen të ushtrohen / zhvillohen në hapësirat publike të Bashkisë janë:

- a/** Ofrimi i shërbimeve restorative dhe rekreative
(si, por pa u kufizuar, në bare, restorante, fast-food, pizeri, hoteleri e të ngjashme)
- b/** Zhvillim i aktiviteteve ambulatorë në hapësirat publike
- c/** Ekspozimi i mallrave jashtë njësisë së tregtimit
- d/** Zhvillimi i panairëve
- e/** Zhvillim i aktiviteteve argëtuese, kulturore dhe manifestimet politike
- f/** Hapësirat reklamuese (Citylights)

➤ PAJISJET E LEJUARA, FORMAT, MATERIALET & NGJYRAT

➤ Lejohet vetëm përdorimi i pajisjeve të përcaktuara në lejen për shfrytëzimin e hapësirës publike. Subjektet janë të lirë të zgjedhin format, materialet dhe ngjyrat e tyre.

➤ Pajisjet duhet të jenë lehtësisht të çmontueshme. Pajisjet nuk duhet të kenë pamje estetike të konsumuar dhe të çrregullt.

➤ Në zona me rëndësi të veçantë social-kulturore apo ekonomiko-administrative, në të cilat synohet të kultivohet dhe ruhet një estetik urbane uniforme, përdorimi i formave, materialeve dhe ngjyrave specifike për pajisjet nga subjektet e interesuar mund të përcaktohet me akte të Kryetarit të Bashkisë.

➤ Nëse Bashkia ndryshon format, përmasat apo ngjyrat e pajisjeve në një zonë të caktuar, atëherë pajisjet duhet të ndryshohen sipas udhëzimeve të saj pa patur nevojë për një leje të re. Bashkia ka për detyrë t'ia komunikojë këtë subjekteve, ndërsa subjektet kanë për detyrë të bëjnë ndryshimet me shpenzimet e tyre.

➤ PAJISJET E NDALUARA

Nuk lejohet zënia e hapësirës publike në rastet kur:

A/ Pengon qarkullimin normal të këmbësorëve dhe automjeteve

(I) në buzë të trotuarit që korrespondon me vazhdimin e vijave të bardha për lëvizjen e këmbësorëve

(II) në ishujt e trafikut.

Përrjashtime bëjnë ato raste në të cilën kjo nuk përbën asnjë shqetësim për lëvizjen e këmbësorëve dhe atë të automjeteve

(III) në vendndalimet dhe vendqëndrimet e përcaktuara për mjetet e transporti

(IV) në rastet kur bëhet pengesë për shikimin e sinjalistikës rrugore

B/ Dëmton / cënon dekorin e qytetit

C/ Nuk përmbush normat higjieno-sanitare

D/ Bie në kundërshtim me interesat e komunitetit

E/ Bie në kundërshtim me distancën e sigurisë nga stacionet e karburantit, që gjithësesi nuk mund të jetë më pak se 5 metra nga to.

F/ Në vendet që ka monumente duhet lënë një hapësirë e nevojshme, e cila të mos e pengojë shikimin e monumentit.

G/ në zonat me vlera historike me karakteristika të veçanta mund të jepet leje vetëm në rastet kur garantohet një lëvizje e lirë e këmbësorëve dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

H/ në kryqëzimet në të cilët nuk ka semaforë zënia e hapësirës publike mund të bëhet vetëm jashtë trekëndëshit të shikimit, pra të mos përbëjë asnjë vështirësi në shikim.

➤ MIRËMBAJTJA DHE DËMTIMET

Subjektit i cili është pajisur me leje duhet:

- (i) **të garantojë një përdorim të sigurtë** të hapësirës publike për kalimtarët, në përputhje me dekorin e qytetit dhe në gjendje perfekte higjeno-sanitare.
- (ii) **të mirëmbajë pajisjet**, të cilat duhet të jenë gjithnjë në rregull dhe të pastra.
- (iii) **të mbajë pajisjet në efikasitet të plotë**, në rast të kundërt ndaj tij do të merren masa deri në anulimin e lejes.

◀ SHËNIM

Çdo dëm që i shkaktohet qytetarëve apo hapësirës publike nga aktiviteti që zhvillohet në të do t'i faturohet subjektit i cili është i pajisur me leje. Dëmi ekonomik (psh. në trotuar, pemë apo hapësirën e gjelbër), vlerësohet nga strukturat përkatëse të Bashkisë.

➤ KTHIMI I HAPËSIRËS PUBLIKE

- Hapësira publike duhet të lihet e lirë nga çdo pajisje në rastet kur Bashkia duhet të kryejë punime në interes të publikut, ose punime mirëmbajtje.
- Bashkia, të paktën 15 ditë përpara fillimit të punimeve, duhet t'i komunikojë subjektit me shkrim datën në të cilën hapësira duhet lënë e lirë.
- Kur hapësira publike duhet lënë e lirë në mënyrë urgjente, komunikimi nga ana e Bashkisë mund të bëhet në mënyrë verbale, duke e konfirmuar në vijim e pavonesë në formë të shkruar. Kur nuk është i mundur komunikimi verbal (aktiviteti është mbyllur), në këtë rast Bashkia e kryen vetë lirimimin e territorit dhe koston e punimeve ia faturon subjektit.

Hapësira publike duhet të kthehet në gjendjen e saj të mëparshme në rastet kur:

- A/** Subjekti nuk është i lejuar të ushtrojë aktivitetin
- B/** Kalon data e përfundimit të lejimit
- C/** Anullohet leja/autorizimi

◀ SHËNIM

Nëse lirimimi i saj nuk e bëhet nga vetë subjekti, organet përkatëse të Bashkisë do marrin masa për lirimimin e hapësirës publike dhe kostoja për lirimimin e saj do t'i faturohet subjektit përgjegjës.



PAJISJA ME LEJE SHFRYTËZIMI TË HAPËSIRËS PUBLIKE



➤ DOKUMENTAT E NEVOJSHME PËR APLIKIM LEJA PËR ZËNIEN E HAPËSIRËS PUBLIKE

Subjektet që do të aplikojnë për leje duhet të mbajnë parasysh disa rregulla për plotësimin e dokumentacionit si më poshtë:

✓ 1/ Deklaratë përgjegjësie e aplikuesit

DEKLARATË
<ul style="list-style-type: none">➤ Mbjaj përgjegjësi civile dhe penale për çdo lloj dëmi që i shkaktohet palëve të treta nga aktiviteti që do të zhvilloj.➤ Deklaroj respektimin e Urdhërësës së Kryetarit të Bashkisë me Nr. 10663, datë 21.03.2016 "Rregullat dhe kushtet e zënies së hapësirës publike në Bashkinë e Tiranës".➤ Të ruaj qetësinë publike dhe të mbaj pastër ambientin përreth.➤ Marr persiper qe per nje periudhe 10 ditore te dorezoj gjithe dokumentacionin e kerkuar nga DPTTV.
Kërkuesi _____

✓ 2/ Ekstraktin aktual të lëshuar nga QKB (dokument origjinal)

✓ 3/ KOPJE TË RENDERAVE - përballë, majtas, djathtas dhe brenda në rastet për njësitë e mbyllura (dokument origjinal).

Foto të qarta dhe në to duhet të jenë të pasqyruara veças pamja ballore, pamjet anësore dhe për njësitë e mbyllura edhe një pamje e brendëshme. Në të gjitha fotot duhet të jetë e shënuar data e kryerjes së tyre.

✓ 4/ SKICA të firmosura e vulosura nga persona të licencuar në këtë fushë (arkitekt/inxhinier); (dokument origjinal).

✓ 5/ RILEVIMI TOPOGRAFIK I TERRITORIT NË PRONËSI Realizohet nga një topograf i licensuar.

- shkalla në varësi të sipërfaqes së zonës
- formati A3 (e printuar dhe digjitale - CD)
- firmosur nga ekspert i licensuar

▶ SHËNIM

Bashkëlidhur LICENSA E TOPOGRAFIT E NOTERIZUAR



6/ KËRKESA E LEJES PËR ZËNIEN E HAPËSIRËS PUBLIKE

Kërkesa e lejes për zënie e hapësirës publike vihet në dispozicion nga **Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore**, pranë Bashkisë së Tiranës.

Nr. _____ Prot. Datë _____ DPTTV	<h1>KËRKESË</h1>	Aneksi Nr.1
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE <i>PËR PAJISJEN ME/NDRYSHIM/RINOVIM</i>		
LEJE		
PËR ZËNIE HAPËSIRE PUBLIKE NGA AKTIVITETET RESTORATIVE DHE/OSE REKREATIVE		
Unë i nënshkruari _____ banues në adresë Tel cel..... dhe me dokument identifikimiNr.....		
<small>Bazuar në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1/1.1, shkronjat "a" dhe "b", nenit 23, pika 14 dhe nenit 64, shkronja "a" të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen vendore"; Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; nenit 4/1 të Ligjit Nr.107/2014, datë 31.07.2014 për "Planifikimin dhe zhvillimin e territorit" (i ndryshuar); nenit 8 të Ligjit Nr.8224, datë 15.05.1997 për "Organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe komunës" (i ndryshuar); nenit 10, 11, 15 dhe 17 të Vendimit të Këshillit Ministrave Nr.1096, datë 28.12.2015 për "Miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike"; Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.37, datë 03.09.2015 për "Gjobat për dëmtime në rrjetin rrugor, rrjetin elektrik rrugor dhe hapësirat e gjelbra të Bashkisë Tiranë dhe metoda e vlerësimit të dëmit"; pikës II.b të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.59, datë 30.12.2015 për "Sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës" (i ndryshuar) si dhe Urdhërësës së Kryetarit të Bashkisë Nr.10663, datë 21.03.2017 për "Rregullat dhe kushtet e zënies së hapësirës publike në Bashkinë e Tiranës".</small>		
KËRKOJ:		
<input type="checkbox"/> Pajisjen me leje për zënie hapësire publike nga aktivitetet restorative dhe/ose rekreative për periudhën __ __, nga ora __07.00 __-__		
<input type="checkbox"/> Rinovimin e lejes për zënie hapësire publike nga aktivitetet restorative dhe/ose rekreative për periudhën _____, nga ora _____.		
PËR:		
Sipërfaqja e hapësirës publike në m ² _____		
Bashkëlidhur dorëzohj dokumentet e mëposhtme:		
<input type="checkbox"/> 1. Deklaratë përgjegjësie e aplikuesit;		
<input type="checkbox"/> 2. Ekstraktin aktual të lëshuar nga QKB (dokument origjinal);		
<input type="checkbox"/> 3. Kopje të renderave (përballë, majtas, djathtas dhe brenda në rastet për njësitë e mbyllura) (dokument origjinal);		
<input type="checkbox"/> 4. Genplani i azhurnuar dhe planimetrinë e hapësirës ku zhvillohet aktiviteti (dokument origjinal);		
<input type="checkbox"/> 5. Skica të firmosura e vulosura nga persona të licencuar në këtë fushë (arkitekt/inxhinier) (dokument origjinal);		
<input type="checkbox"/> 6. Si dhe çdo dokument tjetër bazuar në Urdhërësën e Kryetarit.		

KËRKUESI ____
Plotësohet nga specialisti i DPTTV-se
(SPECIALISTI) ____ Tiranë, më/...../.....
Përgjigja do të merret brenda datës/...../.....(sipas afatit ligjor 15 ditë nga data e aplikimit)
Përgjigjen lutemi ta tërhiqni pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore. <i>Kjo kërkesë përpilohet në dy kopje ku njëra protokollohet dhe tjetra i jepet kërkuarit.</i>
1. Tarifapër zënie hapësire publike Zona A është 1.500 lekë/m²/muaj
2. Tarifa për zënie hapësire publike Zona B është 750 lekë/m²/muaj
3. Tarifa për zënie hapësire publike Zona C (Qyteti, Dajt, Farkë, Kashar) është 400 lekë/m²/muaj
4. Tarifa për zënie hapësire publike Zona NJ.të tjera Administrative është 200 lekë/m²/muaj

1/2

**SHQYRTIMI I KËRKESËS
AFATET KOHORE
PAGESA E TARIFES SË APLIKIMIT**
PËR LEJEN E SHFRYTËZIMIT TË HAPËSIRËS PUBLIKE



➤ AFATET KOHORE

Afatet për shqyrtimin e kërkesave ndryshojnë në varësi të kategorisë së aktivitetit dhe lejes së kërkuar, por në çdo rast nuk tejkalohet afati **30 ditor** nga momenti i marrjes së aplikimit. Nëse subjekti i interesuar ndryshon qëndrim, subjekti duhet t'ia komunikojë atë organit përkatës në Bashki brenda afatit të shqyrtimit të kërkesës.

Ushtrimi i aktivitetit në hapësirat publike është **i përkohshëm**.

Kohëzgjatja e tij përcaktohet në varësi të kategorisë së aktivitetit që subjekti kërkon të ushtrojë. Për disa kategori të caktuara ushtrimi i aktivitetit në hapësirën publike mund të jetë i kufizuar vetëm në ditë apo në orë të caktuara.

➤ DETYRIMET FINANCIARE

Dhënia e lejes për zënie e hapësirës publike kushtëzohet nga pagesa e tarifës së përcaktuar në Pikë II.b. të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 59 dt. 30.12.2015 për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë së Tiranës”, e cila varion në bazë të zonës në të cilën subjekti zhvillon aktivitetin e tij dhe sipërfaqen e hapësirës publike të zënë në m².

Pagesa bëhet pranë **Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë së Tiranës** ose në bankat e nivelit të dytë.

➤ PAJISJA ME LEJE PËR ZËNIEN E HAPËSIRËS PUBLIKE

➤ *Leja për zënie e hapësirës publike duhet të vihet në dispozicion nga subjekti në çdo rast që kërkohet nga organet inspektuese.*

➤ *Leja duhet të mbahet gjithnjë në kopje origjinale dhe të jetë e vendosur në një vend të dukshëm.*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË


BASHKIA
TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE
LEJE

Nr. _____, datë ____/____/2018

PËR
ZËNIE HAPËSIRE PUBLIKE NGA AKTIVITETET RESTORATIVE DHE/OSE REKREATIVE

Bazuar në nenin 8, pika 2, nenin 9, pikat 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenin 23, pika 14 dhe nenin 64, shkronja “a” të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; Ligjit Nr.44/2015, datë 17.12.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenin 4/1 të Ligjit nr.107/2014, datë 31.07.2014 për “Planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar); Ligjit Nr.8224, datë 15.05.1997 për “Organizimin dhe funksionimin e policisë së Bashkisë dhe Komunës” (i ndryshuar); nenin 10, 11, 15 dhe 17 të Vendimit të Këshillit Ministrave Nr.1096, datë 28.12.2015 për “Miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.37, datë 03.09.2015 për “Gjobat për dëmtime në rrjetin rrugor, rrjetin elektrik rrugor dhe hapësirat e gjelbra të Bashkisë Tiranë dhe metoda e vlerësimit të dëmit”; pikës II.b të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.59, datë 30.12.2015 për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” (i ndryshuar) si dhe Urdhërësës së Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr.10663, datë 21.03.2017 për “Rregullat dhe kushtet e zënies së hapësirës publike në Bashkinë e Tiranës”,

I LËSHOHET

Subjekti:

Objekti i aktivitetit:

Sip. zënies së hapësirës publike për: Sip. m²

Me adresë ushtrimi aktiviteti:

Nr. NIPT:

E vlefshme deri më:

Drejtor i Përgjithshëm

Bashkëlidhur lejes subjekti duhet të ketë edhe planvendosjen për zënie e hapësirës publike (e vulosur e firmosur nga një person i licencuar në këtë fushë)

Shënim: Drejtorja e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, mbështetur në politikën e saj, në rolin e rregullatorit, ka të drejtë të pezullojë apo anulojë lejen e mësipërme në çdo moment.

➤ LEJA PËR ZËNIEN E HAPËSIRËS PUBLIKE

➤ LEJA ËSHTË E PAVLEFSHME kur:

- 1/ I ka përfunduar afati i vlefshmërisë
- 2/ Në të janë bërë të pa lexueshme ose mungojnë specifikimet e mëposhtme:
 - a) emri i subjektit
 - b) adresa
 - c) nëshkrimi i autoritetit kompetent
 - d) vula përkatëse

➤ LEJA HIQET nga autoriteti kompetent që e ka lëshuar atë, kur:

- 1/ Nuk plotëson kërkesat e parashikuara nga legjislacionin në fuqi
- 2/ Provohet se subjekti ka paraqitur informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e lejes dhe/ose gjatë ushtrimit të aktivitetit
- 3/ Shkelen kushtet e vendosura në këtë leje.

➤ SUBJEKTI I PAJISUR ME LEJE, duhet:

- Të garantojë një përdorim të sigurt të hapësirës publike për kalimtarët, në përputhje me dekorin e qytetit dhe në gjendje perfekte higjeno-sanitare
- Të mirëmbajë pajisjet, të cilat duhet të jenë gjithmonë në rregull dhe të pastra
- Inspektimi i zënies së hapësirës publike mund të bëhet sa herë gjykohet nga shërbimet përkatëse të qeverisjes vendore për të konstatuar funksionimin e mirë dhe në përputhje me ligjet në fuqi.

➤ Të merren **MASA NDËSHKUESE** për subjektin në rastet kur:

- Ushtrohet aktiviteti në një hapësirë më të madhe se ajo e përcaktuar në lejen e dhënë
- Instalohen pajisje për të cilat nuk është marrë leje përkatëse
- Nuk paguan tarifën për zënie e hapësirës publike brenda afateve të përcaktuara në leje

◀ SHËNIM

Subjekti mban përgjegjësi për zbatimin e legjislacionit në fuqi.

1/3

**HARTIMI I PROJEKTIT TEKNIK
TË REALIZIMIT TË PUNIMEVE**



➤ PROJEKTI TEKNIK I RELIZIMIT TË PUNIMEVE, DUHET TË PËRMBAJË:

➤ 1/ PLANIMETRI TË GJENDJES EKZISTUESE


➤ 2/ PLANIMETRI TË NDËRHYRJEVE

➤ 3/ RELACIONI TEKNIK I REALIZIMIT TË PUNIMEVE

➤ 4/ LIÇENSA INDIVIDUALE E PROJEKTUESIT ME KATEGORITË PËRKATËSE PËR PUNIMET QË DO TË KRYHEN, BRENDA AFATIT TË VLEFSHMËRISË.

◀ SHËNIM

Projekti teknik i realizimit të punimeve firmoset në mënyrë elektronike nga një arkitekt i licencuar.



1/4 DOKUMENTAT E NEVOJSHME
PËR APLIKIM ME DPKP
NË PRONË PUBLIKE



➤ DOKUMENTAT E NEVOJSHME PËR APLIKIM ONLINE ME DPKP NË PRONË PUBLIKE

Pas pajisjes me dokumentin e lejes për shfrytëzimin e hapësirës publike, personi / subjekti aplikon për DPKP në **PORTALIN ONLINE E-LEJE**, pjesë e platformës **E-ALBANIA** me dokumentat e mëposhtme:

- ✓ **1/ LEJA PËR SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRËS PUBLIKE** (bashkëlidhur gjithë detajimet: skica, rreza, plan rievimi). **SHIKO HAPIN 1/1**
- ✓ **2/ PROKURË** nga personi / subjekti i cili është pajisur me lejen e hapësirës publike për autorizimin e aplikuesit (projektues te licensuar)
- ✓ **3/ DEKLARATË NOTERIALE** nga personi / subjekti i cili është pajisur me lejen e hapësirës publike për punimet që do të kryejë.

◀ SHËNIM

Portalin online e-lege mund ta aksesoni në adresën:
www.e-albania.al
në të cilin mund të gjeni udhëzimet për mënyrën e përdorimit.

- ✓ **4/ PROJEKTI TEKNIK** i realizimit të punimeve (i nënshkruar elektronikisht nga projektuesi) Bashkëlidhur projektit teknik (i cili përmban planimetri të gjendjes ekzistuese dhe planimetri të ndërhyrjeve) duhet të ngarkohen gjithashtu:

4.1/ Relacioni teknik i projektuesit i firmosur elektronikisht

4.2/ Liçensa individuale e projektuesit me kategoritë përkatëse për punimet që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë.

- ✓ **5/ Deklarata e përgjegjësisë profesionale të projektuesit**

- ✓ **6/ FORMATI I APLIKIMIT** i nënshkruar elektronikisht (e - leje - i firmosur elektronikisht nga aplikuesi)

! KUJDES

Në rastin kur punimet që kryhen me deklaratë paraprake për kryerje punimesh shtrihen në territorin e më shumë se një bashkie, aplikuesi do të paraqesë dokumentacionin përkatës pranë secilës bashki, për punimet që përfshihen brenda territorit administrativ të kompetencës.

02 APLIKIMI ME DEKLARATË PARAPRAKE
PËR KRYERJE PUNIMESH
NË **PRONËSI PRIVATE**



2/1

APLIKIMI ME DPKP NË PRONËSI PRIVATE
ME ÇERTIFIKATË PRONËSIE



ÇERTIFIKATA E PRONËSISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË PËR VËRTETIM PRONËSIE 1002180

Zyra e Regjistrimit _____ Zona Kadastrale Nr. _____
Numri i Pasurisë _____ Volumi _____ Faqe _____
Adresa e Pasurisë _____
Lloji i Pasurisë _____
Sipërfaqja Totale _____
Nga kjo : Sa Truall _____ Nga kjo : Sa Ndërtesa _____
Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes _____ %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mblenri	Pjesa	Adresa

është pronari
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kufizimet e pasurisë janë : V _____ L _____ J _____ P _____

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.
Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesiuar(i) më datë _____ Nr. _____

Lëshuesi i certifikatës, REGJISTRUESI

Data e lëshimit të certifikatës _____

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUEJTSHME TIRANË

REGJISTRUESI _____

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT
(Fraqment)

A. IDENTIFIKIMI I PËRSHURISË:
ZONA KADASTRALE VOL _____ FO _____
NR. I PASURISE: _____ SHKALLA: _____
INDEKSI I HARTES: _____ Q/F _____
ADRESA E PASURISE Rrethi _____
Rr/L: _____ P/K: SH _____ K _____ Ap _____

B. KUFIZIMET _____
V. _____
L. _____
J. _____
P. _____

C. PRONARI _____

D. Data: _____ **Ora:** _____

Vula/Firma

X: 400385.876 Y: 4572287.646 X: 400481.768 Y: 4572287.646

SHËNIM

Në rastet kur përdorimi / funksioni i ambientit është i ndryshëm nga ai i specifikuar në certifikatën e pronësisë, këshillohet të bëhet ndryshimi bazuar në VKM nr.408, dt. 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, neni 12.

- Leja për ndryshimin e aktiviteteve dhe funksioneve të njësisë individuale, jepet nga Autoriteti i zhvillimit me kusht mosndryshimin e sistemit konstruktiv, në bazë të përputhshmërisë me kategoritë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës të përcaktuara nga PPV-ja ose PDV-ja.

- Në mungesë të PPV-së ose PDV-së, ndryshimi i aktiviteteve dhe funksioneve duhet të bëhet në përputhje me kategoritë dhe nënkategoritë e përdorimit ekzistues të tokës.

SHËNIM

Në rast se në Kartelën e Pasurisë së Paluajtshme, pronari ka shënime në “Seksionin e qerave, në përdorim, serviturave dhe interesave të tjera” apo në “Seksiönin e hipotekave, vendimeve të gjykatës, kufizimeve, etj”, do të ketë kërkesa të vecanta (vërtetime apo çdo shkresë tjetër që është e nevojshme) në varësi të komenteve përkatëse nga autoriteti përgjegjës.

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Mësohu nga V.K.N. Nr. 519, Datë 7.11.1994 KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME Vili _____ Fq _____
A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TË PASURISË Vizioni nga Vol _____ Fq _____
Zona Kadastrale: _____ NR.I PASURISË: _____ Vizioni ne Vol _____ Fq _____ deri në Vol _____ Fq _____
Indeksi i Hartes: _____ Vizioni ne Vol _____ Fq _____
Adresa e Pasurisë: Rrethi _____ Q/F _____ PER UNDMIT: RE (data): _____
Rr/L: _____ P/G _____ SH _____ K _____ Ap _____ Përkrahimi i veçantë: _____

B - SEKSIONI I PËRSHKRIMIT TË PASURISË
Lloji i Pasurisë: _____ Brendu V.K.N.: _____, Ref: _____

Sip. Totale e Pasurisë:	Nga Sip. Totale: sa Truall:	Nga Sip. Truall: sa Ndërtes:	Per pjesen e përbbshkë:
1. _____ m ² Ref: _____	1. _____ m ² Ref: _____	1. _____ m ² Ref: _____	Kuota e pjesëmarrjes: _____ % Nr i Pasurisë (pallat): _____ Vol _____ Faqe _____
2. _____ m ² Ref: _____	2. _____ m ² Ref: _____	2. _____ m ² Ref: _____	
3. _____ m ² Ref: _____	3. _____ m ² Ref: _____	3. _____ m ² Ref: _____	
4. _____ m ² Ref: _____	4. _____ m ² Ref: _____	4. _____ m ² Ref: _____	

C - SEKSIONI I PRONËSISË

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Emri	Atësia	Mblenri	Nr. Pasp	UF/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Certifikatës	Shënime	Firma

Shënime: Kategoria UF/B tregon: 1 - individ, person fizik ose juridik; 2 - përfaqësues i familjes; 3 - bashkëpronar (%)

D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PËRDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE, SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përkrahimi	Data e Lësh. Certifikatës	Shënime	Firma

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, ETJ

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përkrahimi	Data e Lësh. Certifikatës	Shënime	Firma

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QENDRORE E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME TIRANË
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME TIRANË
Adresa: Rruga Jordan Misja, Tiranë

SHËNIM: Kjo kopje e kartelës në AA, ka fuqi të njëjtë me origjinale dhe është e detyrueshme për zyrën tuaj. Në regjistrim Ve _____, Faqe _____, Zona Kadastrale _____, Qyteti Tiranë

REGJISTRUESI _____

2/1

APLIKIMI ME DPKP NË PRONËSI PRIVATE
ME KONTRATË
POROSIE / SIPËRMARRJE / QERAJE



> LLOJET E KONTRATËS PËR APLIKIM ME DPKP

Aplikuesi mund të aplikojë për DPKP edhe me:

1/ KONTRATË POROSIE / SIPËRMARRJE

Në rastin kur subjekti ndërtues lidh kontratë me pronarin / palë të treta për pasurinë mbi të cilën kërkohet kryerja e punimeve.

2/ KONTRATË QERAJE

Në rastin kur ambjenti/ pasuria mbi të cilën kërkohet kryerja e punimeve është marrë me qera nga një person i tretë.

◀ SHËNIM

Kontrata e qerasë është e vlefshme për të dyja rastet:

- Kur pasuria është e regjistruar në ZVRPP
- Kur ka kontratë sipërmarrje

2/2

**HARTIMI I PROJEKTIT TEKNIK
TË REALIZIMIT TË PUNIMEVE**



➤ PROJEKTI TEKNIK I RELIZIMIT TË PUNIMEVE, DUHET TË PËRMBAJË:

➤ 1/ PLANIMETRI TË GJENDJES EKZISTUESE


➤ 2/ PLANIMETRI TË NDËRHYRJEVE

➤ 3/ RELACIONI TEKNIK I REALIZIMIT TË PUNIMEVE

➤ 4/ LIÇENSA INDIVIDUALE E PROJEKTUESIT ME KATEGORITË PËRKATËSE PËR PUNIMET QË DO TË KRYHEN, BRENDA AFATIT TË VLEFSHMËRISË.

◀ SHËNIM

Projekti teknik i realizimit të punimeve firmoset në mënyrë elektronike nga një arkitekt i licencuar.



2/3

**DOKUMENTAT E NEVOJSHME
PËR APLIKIM ONLINE ME DPKP
NË PRONË PRIVATE**



➤ DOKUMENTAT E NEVOJSHME PËR APLIKIM ONLINE ME DPKP NË PRONË PRIVATE

✓ **1/ Pajisja me VËRTETIMIN E PRONËSISË** nga Hipoteka / Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP)

▶ **SHËNIM:** Në rast se aplikuesi nuk është i pajisur me dokument pronësie, mund të aplikojë me:

- kontratë porosie

- kontratë sipërmarrje

- kontratë qeraje

✓ **2/ PROKURË** nga personi / subjekti për autorizimin e aplikuesit (projektues te licensuar)

✓ **3/ DEKLARATË NOTERIALE NGA BASHKËPRONARËT** në rastet e aplikimeve për punime, që kryhen në ambiente në bashkëpronësi të detyrueshme, për riparime si tarracat, shkallët, fasadat etj. zhvilluesi duhet të ketë miratimin e bashkëpronarëve të godinës ku kërkon të kryejë punime

✓ **4/ PROJEKTI TEKNIK** i realizimit të punimeve (i nënshkruar elektronikisht nga projektuesi) Bashkëlidhur projektit teknik (i cili përmban planimetri të gjendjes ekzistuese dhe planimetri të ndërhyrjeve) duhet të ngarkohen gjithashtu:

◀ SHËNIM

Projekti teknik i realizimit të punimeve duhet të jetë i nënshkruar elektronikisht nga projektuesi

4.1/ **Relacioni teknik** i projektuesit i firmosur elektornikisht

4.2/ **Liçensa individuale e projektuesit** me kategoritë përkatëse për punimet që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë.

✓ **5/ DEKLARATA E PËRGJEGJËSISË PROFESIONALE** të projektuesit

✓ **6/ LIÇENSA INDIVIDUALE E PROJEKTUESIT** me kategoritë përkatëse për punimet që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë.

✓ **7/ FORMATI I APLIKIMIT** i nënshkruar elektronikisht (e - leje, i firmosur elektronikisht nga aplikuesi)

! KUJDES

Në rastin kur punimet që kryhen me deklaratë paraprake për kryerje punimesh shtrihen në territorin e më shumë se një bashkie, aplikuesi do të paraqesë dokumentacionin përkatës pranë secilës bashki, për punimet që përfshihen brenda territorit administrativ të kompetencës.

◀ SHËNIM

Në bazë të neneve 209-221 të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar).

◀ SHËNIM

Portalin online e-leje mund ta aksesoni në adresën:

www.e-albania.al

në të cilin mund të gjeni udhëzimet për mënyrën e përdorimit.

03 APLIKIMI ONLINE SHQYRTIMI I KËRKESËS AFATET KOHORE



➤ NGARKIMI ELEKTRONIK I DOKUMENTAVE

Kërkesa për leje zhvillimi paraqitet për shqyrtim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, i cili mundëson ngarkimin elektronik të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për *Deklaratë Paraprake për Kryerje Punimesh*.

Lutemi të skanoni të gjitha dokumentat e listuara të cilat do ngarkoni në sistem.

! KUJDES

Përpara ngarkimit të dokumentacionit të nevojshëm për Deklaratë Paraprake për Kryerje Punimesh, sigurohuni që lista e dokumentave të sipërpermendura të jetë e plotë.

! KUJDES

Përpara se të ngarkoni dokumentat në rrjet, është i nevojshëm nënshkrimi elektronik i tyre nga arkitekti i licensuar i cili harton projektin teknik.

➤ KOHËZGJATJA E PROCESIT:

MAX 5 DITË PUNE

SHQYRTIMI I KËRKESËS & KTHIMI I PËRGJIGJES

Brenda **5 ditëve** pune nga dorëzimi i deklaratës paraprake për kryerje punimesh, nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, autoriteti vendor përgjegjës kryen verifikimet e nevojshme dhe, në rast se konstaton mosrespektimin e kushteve dhe kërkesave ligjore që rregullojnë deklaratën paraprake të punimeve, e kundërshton atë me vendim të arsyetuar.


SHENIM !

Në mungesë përgjigjeje nga autoriteti vendor përgjegjës, brenda afatit 5-ditor, **konfirmimi konsiderohet i dhënë në heshtje** dhe sistemi gjeneron aktin përkatës e njofton deklaruesin për mundësinë e fillimit të punimeve.

PERMBLEDHJA E PROCESIT TË APLIKIMIT PËR DPKP



APLIKIMI ME DEKLARATË PARAPRAKE PËR KRYERJE PUNIMESH NË PRONËSI PUBLIKE



PAJISJA ME LEJE SHFRYTËZIMI TË HAPËSIRËS PUBLIKE

1/1 PAJISJA ME LEJE SHFRYTËZIMI TË HAPËSIRËS PUBLIKE

Dokumentat e nevojshme pwr aplikim:

1/ Deklaratë përgjegjësie e aplikuesit

2/ Ekstraktin aktual të lëshuar nga QKB (dokument origjinal)

3/ Kopje të renderave & foto - përballë, majtas, djathtas dhe brenda në rastet për njësitë e mbyllura (dokument origjinal)

4/ Skica të firmosura e vulosura nga persona të licencuar në këtë fushë (arkitekt/inxhinier); (dokument origjinal).

5/ Rilevimi topografik i territorit në pronësi

6/ Kërkesa e lejes për zënie e hapësirës publike vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Traifave Vendore, pranë Bashkisë së Tiranës.

HARTIMI I KËRKESËS, AFATET KOHORE, PAGESA E TARIFES SË APLIKIMIT PËR LEJEN E SHFRYTËZIMIT TË HAPËSIRËS PUBLIKE

AFATET KOHORE

Afatet për shqyrtimin e kërkesave ndryshojnë në varësi të kategorisë së aktivitetit dhe lejes së kërkuar, por në çdo rast nuk tejkalohet afati 30 ditor nga momenti i marrjes së aplikimit.

DETYRIMET FINANCIARE

Dhënia e lejes për zënie e hapësirës publike kushtëzohet nga pagesa e tarifës së përcaktuar në Pikë 11.b. të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 59 dt. 30.12.2015 për "Sistemin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë së Tiranës", e cila varion në bazë të zonës në të cilën subjekti zhvillon aktivitetin e tij dhe sipërfaqen e hapësirës publike të zënë në m².

Pagesa bëhet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë së Tiranës ose në bankat e nivelit të dytë.

PAJISJA ME LEJE PWR ZWNIEN E HAPËSIRËS PUBLIKE

Pasi kanw mbaruar tw gjitha procedurat e apkimit dhe shqyrtimit tw lejes pwr zwnien e hapwsirws publike, jepet mriatimi i lejes, e cila duhet të vihet në dispozicion nga subjekti në cdo rast që kërkohet nga organet inspektuese.

Leja duhet të mbahet gjithnjë në kopje origjinale dhe të jetë e vendosur në një vend të dukshëm.

HARTIMII I PROJEKTIT TEKNIK TË REALIZIMIT TË PUNIMEVE

1/ PLANIMETRI TË GJENDJES EKZISTUESE

2/ PLANIMETRI TË NDËRHYRJEVE

3/ RELACIONI TEKNIK i realizimit të punimeve

4/ LIÇENSA INDIVIDUALE E PROJEKTUESIT me kategoritë përkatëse për punimet që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë.

DOKUMENTAT E NEVOJSHME PËR APLIKIM ME DPKP NË PRONË PUBLIKE

Pas pajisjes me dokumentin e lejes për shfrytëzimin e hapësirës publike, personi / subjekti aplikon për DPKP në PORTALIN ONLINE E-LEJE, pjesë e platformës E-ALBANIA me dokumentat e mëposhtme:

1/ LEJA PËR SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRËS PUBLIKE SHIKO HAPIN 1/1

2/ PROKURË nga personi / subjekti i cili është pajisur me lejen e hapësirës publike për autorizimin e aplikuesit (projektues të licensuar).

3/ DEKLARATË NOTERIALE nga personi / subjekti i cili është pajisur me lejen e hapësirës publike për punimet që do të kryejë.

4/ PROJEKTI TEKNIK i realizimit të punimeve (i nënshkruar elektronikisht nga projektuesi)

4.1/ Relacioni teknik i projektuesit i firmosur elektronikisht

4.2/ Liçensa individuale e projektuesit me kategoritë përkatëse për punimet që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë.

5/ Deklarata e përgjegjësisë profesionale të projektuesit

6/ FORMATI I APLIKIMIT i nënshkruar elektronikisht (e - leje - i firmosur elektronikisht nga aplikuesi)

! KUJDES

Në rastin kur punimet që kryhen me deklaratë paraprake për kryerje punimesh shtrihen në territorin e më shumë se një bashkie, aplikuesi do të paraqesë dokumentacionin përkatës pranë secilës bashki, për punimet që përfshihen brenda territorit administrativ të kompetencës.

APLIKIMI ME DEKLARATË PARAPRAKE PËR KRYERJE PUNIMESH NË PRONËSI PRIVATE

MENYRA E APLIKIMIT ME DPKP ME ÇERTIFIKATW PRONWSIE

Pranë Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) aplikohet për dokumentat e mëposhtme:

1/ Çertifikata e pronësisë

2/ Kartela e pasurisë së paluajtshme

3/ Harta treguese e regjistrimit

MENYRA E APLIKIMIT ME DPKP NW PRONWSI PRIVATE ME KONTRATË POROSIE / SIPËRMARRJE / QERAJE

Aplikuesi mund të aplikojë për DPKP edhe me:

1/ KONTRATË POROSIE / SIPËRMARRJE

Në rastin kur subjekti ndërtues lidh kontratë me pronarin / palë të treta për pasurinë mbi të cilën kërkohet kryerja e punimeve.

2/ KONTRATË QERAJE

Në rastin kur ambjenti/ pasuria mbi të cilën kërkohet kryerja e punimeve është marrë me qera nga një person i tretë.

► SHËNIM

Kontrata e qerasë është e vlefshme për të dyja rastet:

- Kur pasuria është e regjistruar në ZVRPP
- Kur ka kontratë sipërmarrje

HARTIMII I PROJEKTIT TEKNIK TË REALIZIMIT TË PUNIMEVE

1/ PLANIMETRI TË GJENDJES EKZISTUESE

2/ PLANIMETRI TË NDËRHYRJEVE

3/ RELACIONI TEKNIK i realizimit të punimeve

4/ LIÇENSA INDIVIDUALE E PROJEKTUESIT me kategoritë përkatëse për punimet që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë.

DOKUMENTAT E NEVOJSHME PËR APLIKIM ME DPKP NË PRONË PRIVATE

1/ Pajisja me VËRTETIMIN E PRONËSISË nga Hipoteka / Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP)

► SHËNIM: Në rast se aplikuesi nuk është i pajisur me dokument pronësie, mund të aplikojë me:
- kontratë porosie
- kontratë sipërmarrje
- kontratë qeraje

2/ PROKURË nga personi / subjekti i cili është pajisur me lejen e hapësirës publike për autorizimin e aplikuesit (projektues të licensuar)

3/ DEKLARATË NOTERIALE nga personi / subjekti i cili është pajisur me lejen e hapësirës publike për punimet që do të kryejë.

4/ PROJEKTI TEKNIK i realizimit të punimeve (i nënshkruar elektronikisht nga projektuesi)

4.1/ Relacioni teknik i projektuesit i firmosur elektronikisht

4.2/ Liçensa individuale e projektuesit me kategoritë përkatëse për punimet që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë.

5/ Deklarata e përgjegjësisë profesionale të projektuesit

6/ FORMATI I APLIKIMIT i nënshkruar elektronikisht (e - leje - i firmosur elektronikisht nga aplikuesi)

! KUJDES

Në rastin kur punimet që kryhen me deklaratë paraprake për kryerje punimesh shtrihen në territorin e më shumë se një bashkie, aplikuesi do të paraqesë dokumentacionin përkatës pranë secilës bashki, për punimet që përfshihen brenda territorit administrativ të kompetencës.

APLIKIMI ONLINE, SHQYRTIMI I KËRKESËS & AFATET KOHORE

1/ NGARKIMI ELEKTRONIK I DOKUMENTAVE

Kërkesa për leje zhvillimi paraqitet për shqyrtim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, i cili mundëson ngarkimin elektronik të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për leje zhvillimi.

! KUJDES

Përpara ngarkimit të dokumentacionit të nevojshëm për leje zhvillimi, sigurohuni që lista e dokumentave të sipërpërmendura të jetë e plote.

! KUJDES

Përpara se të ngarkoni dokumentat në rrjet, është i nevojshëm nënshkrimi elektronik i tyre nga arkitekti i licensuar i cili harton projekt - idenë.

KOHWZGJATJA E PROCESIT

Brenda 5 ditëve pune nga dorëzimi i deklaratës paraprake për kryerje punimesh, nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, autoriteti vendor përgjegjës kryen verifikimet e nevojshme dhe, në rast se konstaton mosrespektimin e kushteve dhe kërkesave ligjore që rregullojnë deklaratën paraprake të punimeve, e kundërshton atë me vendim të arsyetuar.

SHENIM !

Në mungesë përgjigjeje nga autoriteti vendor përgjegjës, brenda afatit 5-ditor, **konfirmimi konsiderohet i dhënë në heshtje** dhe sistemi gjeneron aktin përkatës e njofton deklaruesin për mundësinë e fillimit të punimeve.

REFERENCA LIGJORE DHE ADMINISTRATIVE:

- *Ligji 107/2014 dt. 31/07/2014 (i ndryshuar) "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*
- *VKM 686 dt.22/11/2017 "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit"*
- *VKM 408 dt. 13/05/2015 (i ndryshuar) "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit"*
- *VKKT nr.1, dt.14.04.17 "Rregullore e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë"*

- *Urdhëresë nr.25850 dt.26.08.2016, për "Rregullat dhe kushtet e zënies së hapësirës publike në Bashkinë e Tiranës."*
- *Vendim nr.23469. dt.29.7.2016, mbi "Miratimin e Rregullores Arkitektonike të Qytetit të Tiranës"*

Udhëzuesi **“Si të aplikosh për Deklaratë Paraprake për Kryerje Punimesh”**, është pjesë e një pakete informative për zbatimin e bazës tekniko - ligjore sipas kushteve të zhvillimit të përcaktuara në legjislacionin dhe rregulloret përkatëse në fuqi, së bashku me:

Udhëzuesin “Si të aplikosh për Plan të Detajuar Vendor”

Udhëzuesin “Si të aplikosh për Leje Zhvillimi”

Udhëzuesin “Si të aplikosh për Leje Ndërtimi”

Përgatitur nga Bashkia e Tiranës me mbështetje teknike të Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Sheshi “Skënderbej”,
Nd. 2, Kodi postar 1001,
Tiranë, Shqipëri

www.tirana.al